



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEQA"

SYLLABUSI I LËNDES: EKONOMETRIA E AVANCUAR

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Biznesit
Titulli i lëndës:	Ekonometria e Avancuar
Niveli:	Doktoratë
Status i lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	I
Numri i orëve në javë:	45 h
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	Semestri pranveror
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës	Kjo lëndë është krijuar për studentët e doktoratës në programin e Biznesit dhe Ekonomisë, duke synuar zhvillimin e aftësive të avancuara në teknikat dhe metodat ekonometrike, të cilat janë të domosdoshme për analizimin e thelluar dhe rigoroz të të dhënave komplekse ekonomike dhe financiare. Kursi ofron një bazë të thelluar në modele statistikore të avancuara dhe përparon me modele komplekse që përdoren për të adresuar marrëdhënie të ndërlikuara midis variablave ekonomike. Kursi mbulon në detaje analiza të ndryshme ekonometrike, duke përfshirë modelet e avancuara të regresionit që mundësojnë vlerësime dhe parashikime të sakta, analiza e kointegrimit për të shqyrtuar marrëdhëniet afatgjata ndërmjet variablave kohorë, si dhe modelet me variabla të varur binarë dhe multinomialë, të cilët përdoren shpesh për vendimmarje në fushat e financës dhe ekonomisë. Studentët do të njihen gjithashtu me modele që analizojnë të dhënat panel, që mundësojnë marrjen e informacioneve më të plota nga të dhënat të cilat kanë një strukturë kohore të kombinuar, si dhe me modelet e serive kohore, të cilat përdoren gjerësisht për parashikimet afatshkurtra dhe afatgjata të treguesve ekonomikë dhe financiarë. Në kuadër të kësaj lënde, do të zhvillohen module të ndryshme për t'i ndihmuar studentët në zbatimin praktik të metodave të avancuara të ekonometrisë në të dhëna reale dhe për zgjidhjen e problemeve të ndërlikuara statistikore. Duke

	përdorur softuerë të specializuar si Stata, studentët do të kenë mundësinë të përfshihen në projekte dhe ushtrime praktike që simulojnë situata reale kërkimore dhe aplikime të drejtpërdrejta në fusha të ndryshme ekonomike dhe financiare. Përmes kombinimit të koncepteve teorike dhe shembujve praktikë, lënda zhvillon aftësinë e studentëve për të formuluar modele ekonometrike komplekse, për të kuptuar dhe analizuar sfidat që lidhen me interpretimin e rezultateve, si dhe për të përdorur këto rezultate në formulimin e politikave dhe vendimeve të bazuara në të dhëna.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimet kryesore të lëndës "Ekonometria e Avancuar" janë: 1. <u>Zhvillimi i aftësive për analizën e të dhënave komplekse</u> – Të sigurohet që studentët të zotërojnë teknika të avancuara në përdorimin e modeleve ekonometrike për analizimin e të dhënave ekonomike dhe financiare të ndërlukuara, duke përfshirë regresionet e avancuara, modelet e serive kohore dhe ato me të dhëna panel. 2. <u>Përvetësimi i modeleve ekonometrike për vendimarrje në financë dhe ekonomi</u> – Të mundësohet përdorimi i modeleve me variabla të varur binar dhe multinominal, duke i mësuar studentët se si të aplikojnë këto teknika për analiza të specifikuara në fushat e financës, menaxhimit dhe politikave ekonomike. 3. <u>Zbatimi i teknikave të kointegritit dhe analizës afatgjatë</u> – Të zhvillohen aftësitë e studentëve për të aplikuar analiza të kointegritit, duke i mundësuar ata të analizojnë marrëdhëniet afatgjata ndërmjet variablave ekonomike dhe të bëjnë parashikime të sakta për politika dhe investime. 4. <u>Përvetësimi i mjeteve të softuerëve për analizën ekonometrike</u> – Të sigurohet njohuri praktike dhe thellimi i përdorimit të softuerëve të specializuar si Stata duke ndihmuar studentët të analizojnë të dhëna reale dhe të krijojnë modele të avancuara në mënyrë efektive. 5. <u>Aftësia për të interpretuar dhe përdorur rezultatet për zhvillimin e politikave dhe vendimarrjen strategjike</u> – Të zhvillohet aftësia e studentëve për të interpretuar rezultatet nga modelet ekonometrike dhe për t'i aplikuar ato në zhvillimin e politikave, strategjive dhe vendimarrjes bazuar në të dhëna konkrete dhe analizë të thelluar.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi, studenti është në gjendje të: o Zotëron aftësi të avancuara në analizën e të dhënave ekonomike dhe financiare – Studentët zotërojnë aftësi të thelluara për të përdorur teknika ekonometrike të avancuara për të analizuar të dhëna komplekse dhe

	për të identifikuar marrëdhënie të ndërlukuara ndërmjet variablave ekonomike dhe financiare. - o Zbaton modelet e avancuara të regresionit për parashikime të sakta – Studentët zbatojnë modele regresioni të avancuara për të vlerësuar dhe parashikuar ndryshime në tregjet financiare dhe ekonomike, duke ofruar rekomandime për zhvillimin ekonomik dhe strategjitë financiare. - o Aplikon analiza të serive kohore dhe modelet e të dhënave panel – Studentët aplikojnë modelet e serive kohore dhe modelet e të dhënave panel për të analizuar ndryshimet dinamike të tregjeve dhe për të bërë parashikime të qëndrueshme afatgjata. - o Vlerëson dhe përdor analizat e kointegrit – Studentët vlerësojnë dhe përdorin analiza kointegrimi për të identifikuar marrëdhëniet afatgjata ndërmjet variablave, duke mundësuar zhvillimin e politikave që mbështesin rritjen e qëndrueshme ekonomike dhe financiare. - o Zbaton softuerë të specializuar për zbatimin e analizave ekonometrike – Studentët zbatojnë softuerë të specializuar si Stata për të realizuar analiza të avancuara të të dhënave dhe për të zhvilluar modele të saktë dhe të besueshëm. - o Zotëron aftësinë për të interpretuar rezultatet dhe për të udhëhequr vendimarrjen strategjike – Studentët zotërojnë aftësinë për të interpretuar rezultatet nga modelet ekonometrike dhe për t'i përdorur ato në zhvillimin e politikave dhe vendimarrjes strategjike, me fokus në rritjen e investimeve dhe zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë. - o Zbaton strategji financiare dhe investimesh të bazuara në analiza ekonometrike – Studentët zbatojnë strategji financiare dhe investimesh bazuar në analiza ekonometrike të avancuara, duke mbështetur zhvillimin e biznesit dhe të ekonomisë lokale. - o Vlerëson dhe implementon projekte ekonomike për zhvillimin e qëndrueshëm – Studentët vlerësojnë dhe implementojnë projekte ekonomike që analizojnë ndikimin e tyre në zhvillimin e qëndrueshëm dhe rritjen ekonomike, duke kontribuar në ndryshimet pozitive të politikave.
--	--

	o Analizon dhe propozon përmirësime në politikat ekonomike – Studentët analizojnë politikat ekzistuese ekonomike dhe propozojnë ndryshime që do të kontribuonin në zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm, përmirësimin e mirëqenies mjedisore dhe sociale, dhe rritjen e mundësive për investime në ekonominë lokale.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjerata	3	9	27
Leximi i literaturës shkencore	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	9	18
Esetë dhe grupet e diskutimit	2	5	10
Përgatitja për provimin final	4	5	20
Hulumtimi dhe mbledhja e të dhënave	3	5	15
Analiza e të dhënave dhe hartimi i punimit hulumtues	5	5	25
Rishikimi/kontrollimi i punimit dhe përgaditja për prezentim	1	5	5
Totali			150
Metodologjia e mësimdhënies:	Metodologjia e mësimdhënies për lëndën " Ekonometria e Avancuar " në programin e doktoratës në Biznes dhe Ekonomi bazohet në një qasje të kombinuar teoriko-praktike, e cila synon të pajisë studentët me aftësi të avancuara në aplikimin e teknikave ekonometrike për analizën dhe interpretimin e të dhënave të avancuara. 1. <u>Ligjerata interaktive</u> : Ligjeratat do të përfshijnë prezantime teorike të koncepteve dhe modeleve të ekonometrisë së avancuar, të mbështetura me		

	shembuj praktikë nga kërkimet më të fundit dhe aplikimet në fushën e ekonomisë dhe biznesit. Diskutimet në grup dhe analizat e rasteve studimore do të inkurajohen për të stimuluar mendimin kritik dhe për të zhvilluar aftësitë e studentëve në analizimin e problemeve të ndërlukuara ekonomike dhe financiare. 2. <u>Punë Praktike dhe workshop-e:</u> Studentët do të marrin pjesë në workshop-e ku do të praktikojnë përdorimin e softuerëve të avancuar si Stata për realizimin e analizave ekonometrike. Këto aktivitete do të mbështeten nga detyra të bazuara në raste reale dhe simulime të modeleve të regresionit, modeleve të serive kohore dhe të dhënave panel, që do të mundësojnë studentëve të zbatojnë njohuritë e tyre në projekte kërkimore konkrete. 3. <u>Prezantime individuale dhe grupe:</u> Studentët do të prezantojnë gjetjet e tyre nga analizat ekonometrike dhe do të marrin feedback nga kolegët dhe mësimdhënësi. Këto prezantime do të ndihmojnë në zhvillimin e aftësive për të interpretuar dhe komunikuar në mënyrë efektive rezultatet e analizave të avancuara, si dhe për të reflektuar mbi qasjet metodologjike të përdorura. 4. <u>Mbështetje në hulumtim:</u> Studentët do të kenë mundësi për konsultime individuale me mësimdhënësin për të diskutuar progresin e tyre në hulumtime, sfidat metodologjike që mund të përballen, dhe për të marrë udhëzime për përdorimin e teknikave dhe softuerëve të avancuar për realizimin e analizave të saktë dhe të besueshëm. Kjo do të sigurojë një mbështetje të vazhdueshme për avancimin e projekteve kërkimore. Kjo metodologji synon të krijojë një mjedis mësimor të balancuar, ku studentët përfitojnë si nga përvetësimi i njohurive teorike të ekonometrisë së avancuar, ashtu edhe nga zhvillimi i aftësive praktike të nevojshme për të realizuar kërkime të avancuara dhe për të kontribuar në analizat dhe politikat ekonomike.
Metodat e vlerësimit:	• Projekti Kërkimor: 60% • Provimi Final: 30% • Pjesëmarrja dhe Diskutimet: 10% Në total, nota përfundimtare do të përbëhet nga këto tre elemente kryesore, duke vlerësuar angazhimin dhe aftësitë e studentit në secilën prej tyre.

Literatura	
Literatura bazë:	▪ Wooldridge, J. M. (2016). <i>Introductory Econometrics: A Modern Approach</i>, Cengage Learning, ISBN: 978-1-305-25193-1. ▪ A. Colin Cameron & Pravin K. Trivedi (2010) <i>Microeconometrics Using Stata</i>. A Stata Press Publication ISBN – 13: 978-1-59718-073-3. ▪ A. Colin Cameron & Pravin K. Trivedi (2005) <i>Microeconometrics, Methods and Applications</i>, Cambridge University Press, ISBN – 13: 978-0-521-84805-3. ▪ Greene, W. H. (2018). <i>Econometric Analysis</i>, Pearson Education, ISBN: 978-013446199,.
Literatura shfresë:	▪ Stock, J. H., & Watson, M. W. (2020). <i>Introduction to Econometrics</i>, Pearson Education, ISBN: 978-0134733896. ▪ Baltagi, B. H. (2020). <i>Econometric Analysis of Panel Data</i>, Springer, ISBN: 978-3030403122. ▪ Hamilton, J. D. (2020). <i>Time Series Analysis</i>, Princeton University Press, ISBN: 978-0691042893.
Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Sesioni i parë:	Hyrje në Ekonometrinë e Avancuar Temat: 1. Përcaktimi i ekonometrisë dhe rëndësia e saj në kërkimin ekonomik dhe financiar. 2. Përmbledhje e teknikave dhe modeleve themelore të ekonometrisë. 3. Përdorimi i software-it të specializuar për analizën ekonometrike. Objektivat: ○ Të sigurohet një kuptim i qartë i bazave të ekonometrisë dhe përdorimit të saj në analizat financiare dhe ekonomike. ○ Të prezantohen softuerët e përdorur në ekonometri si Stata. Aktivitete: Prezantim teorik, demonstrim i softuerëve për analizat ekonometrike.

Sesioni i dytë:	Modelet e Avancuara të Regresionit Temat: 1. Regresioni linear dhe jo-linear i shumëfishtë. 2. Regresioni me variabla të ndryshueshëm. 3. Heteroskedasticiteti. Objektivat: ○ Të zhvillohen aftësitë për të përdorur regresionin për parashikimin dhe vlerësimin e marrëdhënieve ndërmjet variablove ekonomike dhe financiare. ○ Të analizohen modelet e avancuara të regresionit për të zgjidhur probleme praktike. Aktivite: Ushtrime praktike me Stata për regresionet e avancuara dhe analizë të rezultateve nga modelet e regresionit.
Sesioni i tretë:	Modelet e Serive Kohore Temat: 1. Modelet e regresionit të serive kohore. 2. Autoregresionet (AR), Modelet Moving Average (MA), dhe ARIMA. 3. Parashikimi dhe testimi i hipotezave për seritë kohore. Objektivat: ○ Të zhvillohen aftësitë për analizimin dhe parashikimin e të dhënave të serive kohore. ○ Të kuptohen aspektet e modelimit të serive kohore për vendimmarrjen strategjike. Aktivite: Përdorimi i softuerëve për analiza të serive kohore, simulime të parashikimeve dhe testimi i modeleve ARIMA.
Sesioni i katërt:	Modelet e të Dhënave Panel Temat: 1. Modelet e të dhënave panel (Fixed Effects vs. Random Effects). 2. Analiza dhe krahasimi i të dhënave panel me seritë kohore dhe të dhënat e të dhënave kryqëzuese. 3. Përfitimet e përdorimit të të dhënave panel në kërkim. Objektivat: ○ Të zhvillohen aftësitë për të përdorur modelet e të dhënave panel për analiza që kombinojnë informacionin kohor dhe hapësinor. ○ Të përvetësohen metodat për zgjidhjen e problemeve të modelimit dhe testimit. Aktivite: Analizë praktike me Stata për të dhënat panel. Diskutime mbi përdorimin e modeleve të të dhënave panel në kërkime të avancuara.

Sesioni i pestë:	Modelet e Kointegrimit dhe Analiza Afatgjatë Temat: 1. Kointegrimi dhe modeli i kointegrimit. 2. Testet e kointegrimit (Johansen Test). 3. Analiza afatgjatë e marrëdhënieve ndërmjet variablave. Objektivat: ○ Të zhvillohen aftësitë për të analizuar marrëdhëniet afatgjata ndërmjet variablave ekonomike. ○ Të përdoren metodat e kointegrimit për të testuar hipoteza afatgjata në analiza të avancuara. Aktivitete: Ushtrime praktike për testimin e kointegrimit me Stata. Diskutime mbi aplikimin e modeleve të kointegrimit në analizat financiare dhe ekonomike.
Sesioni i gjashtë:	Modelet e Regresionit Binar dhe Multinomial Temat: 1. Regresioni binar dhe multinomial. 2. Modelet për të dhëna diskrete dhe aplikimet e tyre në vendimarrjen strategjike. 3. Analiza e rrezikut dhe optimizimi i portofolieve. Objektivat: ○ Të zhvillohen aftësitë për të përdorur modelet binar dhe multinomial në analizat e vendimarrjes. ○ Të përvetësohet analiza e rrezikut dhe optimizimi në fushën e financave dhe ekonomisë. Aktivitete: Ushtrime për analiza regresioni binar dhe multinomial me softuerë. Rasti studimor për përdorimin e modeleve në vendimarrjen strategjike.
Sesioni i shtatë:	Analiza e Modelit të Rrezikut dhe Optimizimi i Investimeve Temat: 1. Modelet e rrezikut dhe teoritë e menaxhimit të rrezikut. 2. Optimizimi i portofolieve dhe aplikimet financiare. 3. Përdorimi i modeleve ekonometrike për menaxhimin e investimeve. Objektivat: ○ Të zhvillohen aftësitë për të përdorur teknikat e analizës së rrezikut në fushën e financave. ○ Të krijohen modele për optimizimin e portofolieve dhe strategjive financiare. Aktivitete: Përdorimi i softuerëve për analizën e rrezikut dhe optimizimin e portofolieve. Diskutime për rrezikun dhe strategjitë financiare.

Sesioni i tetë:	Zbatimi i Modeleve Ekonometrike në Strategjitë e Politikave Ekonomike dhe Financiare Temat: 1. Zbatimi i modeleve ekonometrike për zhvillimin e politikave dhe vendimmarrjen strategjike. 2. Përdorimi i rezultateve të analizave për zhvillimin e politikave afatgjata. 3. Zhvillimi i modeleve për ritjen e qëndrueshmërisë ekonomike dhe financiare. Objektivat: ○ Të zhvillohen aftësitë për të interpretuar dhe përdorur rezultatet për formulimin e politikave dhe vendimmarrjen strategjike. ○ Të analizohen ndikimet e modeleve në zhvillimin ekonomik dhe përmirësimin e mirëqenies. Aktivite: Diskutime mbi përdorimin e rezultateve të analizave ekonometrike për politikën dhe vendimmarrjen.
Sesioni i nëntë:	Prezentimi i Punimeve Hulumtuese Temat: 1. Prezantimi i projekteve dhe punimeve kërkimore nga studentët. 2. Rishikimi i metodologjisë dhe analizave të përdorura. Objektivat: ○ Të zhvillohen aftësitë për të prezantuar rezultatet e hulumtimeve dhe për të diskutuar metodat e përdorura. ○ Të vlerësohen dhe japin feedback për rezultatet dhe kontributet e studentëve. Aktivite: Prezantimi i punimeve të studentëve dhe diskutimi i rezultateve dhe metodologjisë.

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
Cakto politikat e mirësjelljes konform statusit të UHZ-së. • Para së gjithash, studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat shkollore; • Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, dhe të jetë i vëmendshëm në orën mësimore; • Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e indeksit dhe mjetit të identifikimit në teste dhe provim; • Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet të përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësuesi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit; • Testet dhe provimet vlerësohen individualisht për secilin student. Prandaj, studentet duhet të përqëndrohen vetëm në njohuritë personale.

- Shkelja eventuale e këtyre parimeve etike (rregullave) ndëshkohet konform normave të parapara me ligj.